

# Fugenkittlösung



FILLER



## Provuar për dekada me rradhë

Stuko fugash me bazë tretësi. Për krijim stuko druri. Zgjidhja klasike e stukos për fuga ka dëshmuar se është absolutisht ideale në fushën e rinovimeve. Për shkak të tretësve të avullueshëm rreziku për reaksione me mbetje të shtresave të vjetra bojrash të drurit është më i vogël se në rastin e sistemeve me bazë ujin. Pas tharjes rezulton stuko druri me karakteristika të shkëlqyera mbushëse dhe aderimi.

- Tharje e shpejtë
- Lëmohet shumë mirë
- Cilësi e shkëlqyer ngjyre edhe në drurë ekzotikë
- Parandalon rrjedhjen e vernikut në fuga dhe pore të mëdha

## Gama e përdorimit:

Për mbyllje fugash dhe dëmtimesh të vogla në parkete të ngjitura dhe dysheme druri. Dysheme të vjetra me fuga të gjera dhe të ndotura, si dhe dysheme druri të gozhuara apo të vidhosura mbi kosntrukte druri zakonisht nuk stukohen, sepse stukoja e thatë e drurit shkëputet pjesërisht.

## Të dhëna teknike të produkteve

NR. ARTIKULLI			
11085	5l	4	120
	12l	-	42

<b>Solide</b>	11,5 ±2%
<b>Magazinimi dhe transportimi</b>	24 muaj kohëzgjatja maksimale e magazinimit, merrni parasysh mbishkrimin e kutisë. Nuk ndikohet nga ngrica.
<b>GISCODE</b>	G2

## Udhëzime përpunimi

- Sipërfaqja duhet të jetë lëmuar siç duhet. Dyshemeja duhet të jetë e thatë, pa shtresa të vjetra, vaj, yndyra, dyll, silikon, pluhur lëmimi dhe papastërti të tjera.
- Kushtet optimale të përpunimit eksitojnë në një temperaturë mjedisi nga +15°C deri + 25°C, temperaturë dyshemeje +15°C deri +22°C, lagështirë relative të ajrit 40% - 75%, temperaturë të materialit +18°C - + 25°C, lagështirë maksimale të drurit 12%, ajrosini mjaftueshëm mjediset e punës.
- Për të parandaluar dëmtimet e parketit duhet që gjatë përpunimit të synohet klima e pritshme e mjedisit që pritet në mesin e vitit.
- Tundni mirë materialin.
- Kini parasysh rregullat e përgjithshme dhe specifike të sigurisë së punës për produktin. Me shumë informacion specifik në lidhje me GISCODE mund të gjendet tek udhëzimet e përdorimit, të disponueshme në [www.wingis-online.de](http://www.wingis-online.de).

### HOLLUES

Produkti është gati për përpunim dhe nuk lejohet hollimi!

### MJET APLIKIMI / NORMË APLIKIMI

Shpatull LOBA / afro 100ml/m<sup>2</sup> (10m<sup>2</sup>/l). Konsumimi mund të ndryshojë në varësi të gjerësisë së fugave.

### KOHA E THARJES

- Për fuga të imta, mund të lyhen me rërë pas të paktën 30 minutash.
- Përpunim me produktet me sistemet e rekomanduara të trajtimit të sipërfaqes pas të paktën 2 orësh.

### SISTEME TË PËRSHTATSHME PËR TRAJTIMIN SIPËRFAQËSOR:

- Të gjitha sistemet e vulosjes dhe vajit LOBA.

### PËRDORIMI:

- Pas lëmimit të mesëm (p.sh. granulometri 60) dhe para lëmimit të imët (p.sh. granulometri 100).
- Përziëni produktin me pluhur lëmimi druri sa më të imët, sipas llojit të drurit duke krijuar një lloj paste, stuko të butë.
- Sa më i imët të jetë pluhuri i lëmimit që përdoret, aq më i lehtë është përpunimi me shpatull dhe aq e mirë ngjitja në fuga.
- Para lëmimit të imët e gjithë dyshemeja rrafshohet.
- Në fuga apo dëmtime më të mëdha përsërisni procedurën pas tharjes.
- Hiqni me kujdes mbetjet e përpunimit nga sipërfaqja.
- Pas tharjes, lëmoni plotësisht stukon që ndodhet në sipërfaqe (lëmim i imët).

**Këshillë:** Një rezultat perfekt i ngjyrës arrihet në një raport përzjerjeje sipas peshës prej 1:10 (pjesa e pluhurit të lëmimit në tretjen e stukos).

## Udhëzime të përgjithshme

**Pastrimi i mjeteve të punës:** Pastroni mjetet e punës me tretës, si p.sh. pastrues furçash.

**Koha e tharjes:** Kohët e dhëna të tharjes zbatohen në +20°C dhe lagështi relative 50%, si dhe ajrim i kujdesshëm i zonës së punës, pa rryma. Temperaturat më të ulta, lagështia relative e lartë, mosajrosja e duhur vonojnë tharjen.

**Ngjitje e anëve:** Sistemet e bojrave me bazë ujin në përgjithësi kanë tendencë për ngjitje të cepave. Për të reduktuar formimin e lidhjeve të parregullta dhe ngjitjen e mëvonshme të elementeve këshillohet marrja e masave paraprake si: ngjitje e qëndrueshme elastike ose kundër shtytëse e elementeve të parketit, mbushje të kujdesshme e fugave me stuko, përdorim i astarëve të përshtatshëm si p.sh. LOBA EasyPrime, trajtimi paraprak i anëve të zbrazta të parketeve prej druri solid me dyll të përputhshëm me bojën, para instalimit. Po ashtu, marrja e masave të cilat do ruajnë një klimë të qëndrueshme në dhomë dhe veçanërisht lagështinë relative të ajrit. (Rekomandohet informimi me kujdes i klientit). Veçanërisht të ndjeshme janë dyshemetë e vjetra të dëmtuara ose të paqëndrueshme, parketet prej druri me ngjitje elastike ose të gozhuara, parketet me dërrasa druri, dyshemetë me veshje druri, parketet laminate, parketet mbi dysheme me system ngrohje, drurët me kohë të shkurtër ndryshimi të lagështirës si ah, panja.

**Udhëzime sigurie:** Gjatë procesit të tharjes së produkteve me përbajtje të lartë tretësi krijohen avuj të ndezshëm. Për këtë arsye ndalohet zjarri, drita e zhveshur, saldimi, pirja e duhanit, etj në distance të afërt me këto produkte. Ajrosni mirë ambientin ku punoni dhe magazinoni këto produkte. Pajisjet elektrike dhe ato ndihmëse që ndodhen në ambientet ku punohet duhet të jenë fikur me kohë për të siguruar që ato janë ftohur gjatë fillimit të punës. Çdo lloj shkëndije, duke përfshirë dhe pajisjet elektrike duhet të shmanget. Mbani të mbyllura shumë mirë kutitë e këtyre produkteve. Largoni elementë, bimë apo kafshë me ndjeshmëri ndaj avujve të tretësve, që ndodhen në zonën e emetimit të këtyre avujve.

## Udhëzime të përgjithshme

Informacioni në këtë material si dhe të gjitha këshillat dhe rekomandimet, të cilat ofrojmë në ndihmë dhe asistencë të përdoruesit, janë rezultat i përvojës së deritanishme dhe u referohen kushteve Speziale. Për shkak të mundësive të shumta të aplikimit dhe kushteve të përpunimit, nuk përjashtojmë nevojën e përdoruesit për të kryer testimet e veta ose të kërkojë këshilla teknike duke kontaktuar me Departamentin e aplikimit teknik LOBA. Respektoni standartet aktuale dhe rekomandimet e prodhuesit të produkteve për shtrimin-përpunimin e parketeve.

Detyrimet dhe përgjegjësia jonë përcaktohet ekskluzivisht nga Termat dhe Kushtet tona dhe nuk zgjerohen as përmes këtij informacioni as përmes këshillave tona. Publikimi i të dhënave më të reja teknike automatikisht zhvlerëson ato të mëparshme.

Fjalët dhe simbolet me shenjën ® përfaqësojnë të drejta tregu, të cilat janë të regjistruara dhe të mbrojtura të paktën për hapësirën e Gjermanisë.